

RAPORTI NDËRKOMBËTAR PËR LIRINË E FESË 2017

Shqipëria

Përmbledhje e përgjithshme

Kushtetuta garanton lirinë e ndërgjegjes dhe fesë. Ajo përcakton se nuk ka fe zyrtare, shteti është asnjë në çështjet e besimit, njeh barazinë dhe pavarësinë e grupeve fetare, dhe ndalon diskriminimin bazuar në besimin fetar. Qeveria ka patur marrëveshje me komunitetet myslimane sunit dhe bektashiane, me kishat katolike dhe ortodokse, me vëllazërinë ungjillore të Shqipërisë (VUSH), një organizatë protestante ombrellë, në lidhje me njohjen, kthimin e pronave dhe marrëveshje të tjera. Ligji përcakton se komunitetet fetare do të marrin mbështetje financiare nga qeveria, por marrëveshja e qeverisë me VUSH, sipas ligjit, nuk e përcakton atë në veçanti si marrëse të këtij financimi. Përgjatë vitit, qeveria legalizoi 41 xhami, në krahasim me 137 nga viti i kaluar, 6 në vitin 2015 dhe asnjë në vitin 2014. Grupet fetare raportuan se Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) nuk kishte shqyrtuar asnjë pretendim për kthimin e pronave të sekuestruara gjatë kohës së komunizmit dhe se kishte miratuar vetëm një pretendim për kompensim. ATP deklaroi se qindra pretendime prisnin amendimin e ligjit për pronat përpara se të zgjidheshin. Drejtuesit e VUSH-it vazhduan të deklaronin se pati vështirësi në marrjen e tokave për të ndërtuar objekte kulti dhe probleme në lidhje me pagesat e taksave. Presidenti Ilir Meta i dha nënshtetësinë Kryepeshkopit Anastasios të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, duke deklaruar se ai “kishte rigjallëruar kishën pas komunizmit.” Nga janari deri në maj, qeveria trajnoi 29 mësues në 15 shkolla, si pjesë e një projekti pilot në arsim, i cili synonte të parandalonte radikalizimin dhe të nxiste tolerancën fetare, megjithëse zbatimi i projektit ndaloi në maj dhe vijueshmëria e tij mbeti e paqartë. Parlamenti miratoi një ligj mbi të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare.

Këshilli Ndërfetar, një forum ku drejtuesit e komuniteteve fetare të vendit diskutojnë mbi shqetësimet e përbashkëta, u mbledh tre herë gjatë vitit, ndryshe nga viti i kaluar kur nuk ishte mbledhur. Komuniteti Mysliman Shqiptar u bë objekt kritikash në mediat sociale për atë që u perceptua si fyerje ndaj heroit kombëtar të mesjetës Skënderbeut gjatë festimit të Kurban Bajramit.

Zyrtarë të ambasadës amerikane vazhduan të nxisnin zyrtarët e qeverisë për të përshpejtuar procesin e shqyrtimit të pretendimeve për pronat fetare dhe për t’iu kthyer grupeve fetare ndërtesat dhe prona të tjera të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit. Programet e Ambasadës për të rinjtë vijuan të përqëndrohen në

diversitetin fetar. Programe të tjera të financuara nga Ambasada u përqëndruan në nxitjen e fuqizimit të grave në komunitetet fetare dhe në pajtueshmërinë e besimit dhe demokracisë. Ambasada gjithashtu vazhdoi punën e saj me komunitete fetare për të shkurajuar tërheqjen ndaj ekstremizmit të dhunshëm të lidhur me fenë mes të rinjve. Ambasada financoi pjesëmarrjen e dy personave, përfshirë edhe një ekspert për diversitetin në Policinë e Shtetit, në një program shkëmbimi të ngritur për të nxitur ndërgjegjësimin dhe pranimin e të drejtave njerëzore dhe civile për grupe përfshirë edhe komunitetet minoritare fetare. Ambasada gjithashtu financoi një vizitë shkëmbimi në Shtetet e Bashkuara të përqëndruar në tolerancën fetare për rektorin e universitetit Beder.

Seksioni I. Demografia fetare

Qeveria e SHBA përllogarit popullsinë totale në 3 milionë (përllogaritje e korrikut 2017). Sipas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, myslimanët sunitë përbëjnë afro 57 për qind të popullsisë, katolikët 10 për qind, anëtarët e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë afërsisht 7 për qind dhe anëtarët e Urdhrit Bektashi (një trajtë e sufizmit shiit) në 2 për qind. Grupet e tjera përfshijnë besime protestante, Bahai, Dëshmitarë të Jehovait, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (mormonë) dhe një komunitet të vogël hebre. Afërsisht 20 për qind e personave refuzuan t'i përgjigjeshin pyetjes me zgjedhje për përkatësinë e tyre fetare. Nuk priten përllogaritje të tjera zyrtare deri në mbajtjen e regjistrimit të ardhshëm të përgjithshëm të popullsisë më 2021.

Seksioni II. Gjendja e Respektimit të Lirisë së Fesë nga Qeveria

Kuadri ligjor

Kushtetuta përcakton se nuk ka fe zyrtare, të gjitha besimet janë të barabarta dhe se shteti ka detyrën të respektojë dhe mbrojë bashkë-ekzistencën fetare. Ajo përcakton se shteti është asnjans në çështjet e besimit dhe njeh pavarësinë e grupeve fetare. Sipas kushtetutës, marrëdhëniet mes shtetit dhe grupeve fetare rregullohen me marrëveshje ndërmjet këtyre grupeve dhe Këshillit të Ministrave, të miratuara nga kuvendi.

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe garanton lirinë e ndërgjegjes, fesë dhe shprehjes së lirë. Ajo deklaron se gjithkush është i lirë të zgjedhë ose ndryshojë fenë ose besimet e veta dhe t'i shprehë ato në mënyrë individuale, kolektive, në publik ose privatisht. Kushtetuta shpall gjithashtu se individët nuk mund të detyrohen të marrin pjesë ose të përjashtohen nga pjesëmarrja në komunitete ose

praktika fetare, as të detyrohen të bëjnë publike besimet ose fetë e tyre apo të ndalohen t'i bëjnë këto nëse dëshirojnë. Ajo nuk lejon partitë politike ose grupe të tjera të nxisin urrejte fetare. Kodi Penal ndalon ndërhyrjen në mundësitë e individit për të praktikuar një besim fetar dhe parashikon ndëshkime deri në 3 vjet burg për pengimin e aktiviteteve të organizatave fetare ose për shkatërrimin me qëllim të objekteve ose ndërtesave me vlera fetare.

Sipas ligjit, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr dhe përpunon ankesat për diskriminim, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me praktikat fetare. Ligji specifikon se Komiteti Shtetëror për Kultet, nën juridiksionin e Zyrës së Kryeministrit, rregullon marrëdhëniet mes qeverisë dhe grupeve fetare, mbron lirinë e fesë dhe nxit bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërfeetar. Ligji gjithashtu e udhëzon këtë komitet të mbajë të dhëna dhe statistika mbi grupet e huaja fetare që kërkojnë ndihmë, dhe të mbështesë punonjësit e huaj të grupeve fetare në marrjen e lejeve të qëndrimit.

Qeveria nuk kërkon regjistrim apo licensim të grupeve fetare, por një grup fetar duhet të regjistrohet në Gjykatën e Rrethit si shoqatë jofitimprurëse për t'u kualifikuar për përfitime të caktuara, përfshirë hapjen e një llogarie bankare, zotërimin e pronave dhe marrjen e pjeseshme të statusit të përjashtimit nga taksat. Procesi i regjistrimit kërkon dorëzim informacioni mbi formën dhe qëllimin e organizatës, veprimtarinë e saj, identitetet e themeluesve dhe përfaqësuesve ligjorë të saj, mënyrën e tyre të veprimit me aktorë të tjerë (p.sh. me ministri të qeverisë dhe organizata të qeverisë civile) në një fushë të caktuar, adresën e organizatës, dhe pagesën e një tarife prej 1.000 lekë (9 dollarë) pranë gjykatës së rrethit. Një gjykatës caktohet në mënyrë të rastësishme brenda 3-4 ditësh nga dorëzimi i aplikimit dhe procesi zakonisht përfundon brenda një seance.

Qeveria ka marrëveshje me komunitetet e myslimanëve sunitë dhe bektashianë, kishat katolike dhe ortodokse, si edhe me Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë (VUSH). Marrëveshjet dypalëshe shërbejnë për të kodifikuar marrëveshjet që kanë të bëjnë me njohjen zyrtare, rikthimin e pronës, përjashtimin nga taksa mbi fitimin, donacione dhe prona fetare, dhe përjashtimin nga dorëzimi i të dhënave financiare për aktivitete fetare. Një dispozitë ligjore e miratuar në vitin 2009 përcakton se qeveria do të sigurojë mbështetje financiare për katër komunitetet fetare me të cilat ka pasur marrëveshje në të njëjtën periudhë. Kjo dispozitë ligjore nuk e përfshin VUSH-in, marrëveshja e së cilës me qeverinë daton në vitin 2011. Nuk ka asnjë dispozitë ligjore që përcakton se VUSH duhet të marrë mbështetje financiare nga qeveria.

Ligji i kërkon ATP-së që t'i japë përgjigje pretendimeve nga grupet fetare për prona të konfiskuara gjatë periudhës së komunistit. Ligji lejon komunitetet fetare të drejtojnë institucione arsimore, si dhe të ndërtojnë dhe administrojnë varreza fetare në tokat që ato komunitete zotërojnë.

Shkollat publike janë laike dhe ligji ndalon mësimet fetare në to. Shkollat private mund të ofrojnë mësimet fetare. Sipas shifrave zyrtare të 2016-ës, grupet, organizatat dhe fondacionet fetare kanë 125 shoqata dhe fondacione anëtare që menaxhojnë 116 institucione arsimore, përfshirë universitete, shkolla fillore, të mesme, dhe parashkollore, kopshte, shkolla profesionale dhe jetimore. Sipas ligjit, këto shkolla duhet të licensohen nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe programi jofetar duhet të jetë në përputhje me standardet kombëtare të arsimit. Grupet katolike, myslimane dhe ortodokse kanë në veprim një numër kopshtesh, shkollash dhe universitetesh të licensuara nga shteti. Shumica prej tyre nuk kanë orë fetare të detyruara por i ofrojnë ato me zgjedhje. Komuniteti mysliman ka gjashtë medrese që japin mësimet fetare përpos programit të përcaktuar nga shteti.

Vendi është pjesë e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Praktikat e Qeverisë

Komunitetet katolike, myslimane sunite, ortodokse dhe bektashiane raportuan se mbështetja totale financiare e qeverisë për këto katër grupe mbeti 109 milionë lekë (\$986,000), njësoj si në vitin 2016. Komuniteti mysliman vazhdoi të merrte 28 përqind, ndërkohë që secila prej tri komuniteteve të tjera vazhdoi të merrte 24 përqind. Komunitetet vazhduan t'i përdornin fondet për të mbuluar pjesërisht pagat për personelin administrativ dhe arsimor. Komuniteti bektashian, i cili kishte personel më të vogël se sa të tjerët, vazhdoi të përdorte një pjesë të fondeve që merrte për objekte të reja kulturi.

Qeveria nxori një vendim në prill për të ulur çmimin e energjisë si një lloj mbështetjeje financiare e tërthortë për komunitetet fetare. VUSH raportoi se një numër pronash të saj vazhduan të tarifoheshin me tarifa më të larta që ishin për biznese.

VUSH po ashtu raportoi mungesën e vazhduar të mbështetjes nga qeveria, pavarësisht kërkesave të përsëritura për të amenduar ligjin dhe për të shtuar dispozitën e mbështetjes financiare.

Qeveria vazhdoi procesin e legalizimit të xhamive jozyrtare ndërtuar gjatë viteve 1990, si dhe nxori 41 certifikata pronësie gjatë vitit, krahasuar me 137 gjatë vitit të mëparshëm, gjashtë në vitin 2015 dhe sipas raportimeve asnjë në vitin 2014. Qeveria vazhdoi të kërkonte përkrahjen e KMSH për legalizime.

Qeveria nuk ktheu ndonjë pronë të konfiskuar nën regjimin komunist gjatë vitit; ajo miratoi kompensim për një pronë të vetme – e cila i përkiste komunitetit bektashian. Qeveria deklaroi se ishte përgatitur të ofronte kompensim për 112 prona të tjera, por bashkësitë fetare përkatëse nuk e kishin kaluar ende hapin e kërkuar të kërkesës për fonde. Pavarësisht nga zgjidhja e pretendimit të vetëm gjatë vitit, qindra pretendime paraqitur nga bashkësitë fetare paraqitur pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave prej rënies së komunizmit në vitin 1990 mbetën të pazgjidhura. ATP pranonte se procesi i rikthimit të pronave ishte i ngadaltë, por pohoi se 423 pretendime nga komunitetet fetare ishin zgjidhur së fundmi. Ato ishin në pritje të amendimit të ligjit për pronat të vitit 2015, një pjesë e të cilit ishte shpallur antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese. ATP po ashtu pohoi se vazhdoi të buxhetonte fonde për zgjidhjen e pretendimeve të mëparshme, por të pazbatuara ende në pritje të ndryshimit në dispozitat e ligjit të pronave.

Gjatë një vizite në maj, Reporteri i Posaçëm i OKB-së për Lirinë e Fesë ose Besimit, Ahmed Shaheed, ndërkohë që bëri vlerësime të përgjithshme për përpjekjet e qeverisë për të mbrojtur liritë fetare, po ashtu e nxiti qeverinë t'iu kthente bashkësive fetare pronat e tyre të konfiskuara gjatë regjimit të mëparshëm komunist.

Udhëheqësit bektashianë raportuan se punimet vazhdonin në objektet e kultit në Gjirokastër, Dibër, Përmet dhe Elbasan. Sipas raportimeve, qeveria legalizoi nëntë teqe (objekte kulti) në Gjirokastër, Përmet, dhe Elbasan gjatë vitit. Bektashianët thane se vazhduan të kishin probleme me zyrat e regjistrimit të pronave në Tiranë, Elbasan dhe Gjirokastër, duke vërejtur se procesi i regjistrimit ishte shumë i ngadaltë, burokratik dhe hera-herës i cënueshëm nga korrupsioni.

Anëtarët e VUSH vazhduan të raportnin vështirësi në blerjen e tokës në të cilën të ndërtonin objektet e kultit për shkak të vlerësimeve dhe rregulloreve të qeverisjes vendore. Ata u shprehën se, për pasojë, vazhdonin të merrnin me qera ndërtesa ekzistuese.

Drejtuesit e VUSH raportuan probleme të vazhdueshme në lidhje me taksat për pronën në kishat e tyre. Ata raportuan se autoritetet u impononin gjoba për mosparaqitjen e dokumenteve tatimore që normalisht kërkoheshin vetëm nga

kompanitë fitimprurëse. Në maj, VUSH u takua me autoritetet tatimore, të cilat sipas raportimeve ofruan siguri se gjoba të tilla do të ndalonin, megjithatë VUSH raportoi se gjobat vazhdonin të vlerësoheshin.

Më 22 dhjetor, Presidenti Ilir Meta nënshkroi një dekret për t'i dhënë nënshtetësinë Kryepeshkopit Anastasios të Kishës Ortodokse Autoqefale, dekret i cili doli më 24 dhjetor. Presidenti u shpreh se Anastasios përmbushte kërkesat për nënshtetësi, kishte rigjallëruar kishën pas komunizmit dhe e bëri atë një prej kishave më të nderuara në botë. Ndërkohë që Presidenti dhe Ministri i Jashtëm grek e mirëpritën vendimin, në shoqëri pati njëfarë dënimi dhe reagim të përzier politik brenda vendit.

Instituti për Zhvillimin e Arsimit trajnoi 29 mësues të edukimit qytetar dhe sociologjisë në 15 shkolla pilot midis janarit dhe majit, në zbatim të shpalljes në vitin 2016 nga Kryeministri Edi Rama të një programi të ri për arsimin fetar në shkolla, ndërtuar për të ndihmuar parandalimin e radikalizimit dhe për të promovuar tolerancën fetare. Si Kryeministri ashtu edhe Ministri i Arsimit vazhduan të deklaronin se programi nuk do të ndikonte natyrën laike të sistemit arsimor të vendit. Grupet fetare nuk e kundërshtuan këtë deklaram. Një program mësues pilot temash të përziera u zhvillua për nxënës të klasave të gjashta dhe të dhjeta, edhe pse zbatimi i programit të plotë ndaloi në maj dhe e ardhmja e tij dukej e pasigurt.

Në tetor, Parlamenti miratoi një ligj të ri për pakicat, i cili ofronte mbrojtje shtesë për të drejtat e pakicave, përfshi lirinë e fesë.

Përfaqësues të komuniteteve katolike, ortodokse dhe bektashiane vazhduan të pohonin se regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 paraqiste një pamje të pasaktë të demografisë fetare të vendit sepse numri i tyre ishte nënvlerësuar. Udhëheqësit bektashianë shprehën shqetësim se regjistrimi i popullsisë i kishte klasifikuar shumë prej ndjekësve të tyre si myslimanë dhe jo si bektashianë.

Në maj, eksperti i OKB-së për lirinë e fesë Ahmed Shaheed përfundoi vlerësimin për statusin e lirisë fetare në vend dhe deklaroi se “Shqipëria është një model për harmoninë ndërfaqetare.” Ai i bëri thirrje vendit “të mos e merrte si të qenë” por ta “ruante harmoninë dhe bashkëjetesën unike shoqërore.” Ai shprehu shqetësim lidhur me “financime të panjohura të huaja” por vërejti se “grupet fetare radikale ishin nën kontroll.” Ai gjithashtu nxiti qeverinë që të rikthejë pronat që ishin marrë nga shteti gjatë regjimit të kaluar komunist.

Seksioni III. Gjendja e Respektimit të Lirisë së Fesë nga Shoqëria

Këshilli Ndërfetar, ngritur si forum për drejtuesit e bashkësive katolike, myslimane sunite, ortodokse dhe bektashiane për të diskutuar çështje të përbashkëta, u takua tri herë gjatë vitit, ndryshe nga viti 2016 kur nuk u takua. Në mungesë të një sekretari të përgjithshëm të përhershëm, këshilli zgjodhi Kishën Ortodokse si kreun e parë gjashtëmujor për drejtimin e radhës.

Zgjedhjet e përgjithshme të vendit u mbajtën më 25 qershor, e njëjta ditë si festa e Bajramit të Madh. KMSH nxori një deklaratë ku thuhej se ndonëse data nuk ishte ideale, zgjedhjet paqësore ishin të rëndësishme për vendin dhe të gjithë myslimanët duhet të ushtronin të drejtën e tyre demokratike për të votuar.

KMSH mori kritika në median sociale për një fyerje të perceptuar të Skënderbeut, heroit mesjetar të vendit. KMSH kishte ngritur dy ekrane në vendin ku do të bëhej festa e Kurban Bajramit më 1 shtator, për të patur hapësirë për besimtarët e shumtë, sipas myftiut të Tiranës. Megjithatë, nga disa kënde të caktuara, ekranet pengonin pamjen e statujës së Skënderbeut, edhe pse vëzhguesit nga shumica e këndeve të tjera raportuan se nuk ishte ky rasti. Megjithatë, faqe të medias sociale ishin të mbushura me postime që kritikonin fyerjen e perceptuar nga komuniteti mysliman për kombin.

Seksioni IV. Politikat dhe Angazhimi i Qeverisë

Në takime me komisionerin shtetëror të kulteve dhe ATP, zyrtarë të ambasadës vazhduan ta nxisnin qeverinë për të përshpejtuar trajtimin e pretendimeve për pronat fetare dhe për t'iu kthyer grupeve fetare pronat e tyre konfiskuar gjatë epokës së komunizmit. Në qershor, ambasada sponsorizoi pjesëmarrjen e dy individëve, përfshi një specialist për diversitetin në policinë e shtetit, në një program shkëmbimi me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe pranimit të të drejtave civile për grupet, përfshi bashkësitë e pakicave fetare. Ambasada po ashtu sponsorizoi rektorin e Universitetit Beder për të marrë pjesë në një vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Studim i Instituteve të SHBA) me fokus tek toleranca fetare.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës vazhduan të promovonin tolerancën fetare në takime me bashkësitë myslimane sunite, bektashiane, katolike, ortodokse dhe protestante, si dhe në vizita në kisha, xhami dhe objekte të tjera kulturi. Ambasadori shtroi iftar për të rinj myslimanë nga komunitete të ndryshme ku theksoi vlerën e dialogut dhe tolerancës fetare.

Ambasada vazhdoi programet e saj të edukimit të rinisë dhe punën me bashkësitë fetare për të ulur tërheqjen e mundshme të ekstremizmit të dhunshëm fetar. Si pjesë e këtyre programeve, studentë në shkollat fetare islamike, katolike dhe ortodokse planifikuan dhe zhvilluan projekte që festojnë diversitetin dhe tolerancën fetare. Programe të tjera të sponsorizuara nga ambasada përqendroheshin tek promovimi i fuqizimit të gruas në komunitetet fetare në Elbasan, si dhe tek festimi i diversitetit fetar nëpërmjet klinikave sportive me studentë nga medreset dhe universitetet katolike dhe myslimane. Seminare të tjera sponsorizuar nga ambasada me figura fetare kryesore dhe udhëheqës në qeveri dhe mes akademikëve u përqendruan tek pajtueshmëria midis besimit fetar dhe demokracisë.